

Rathausgasse 1
3011 Bern
Telefon+41 31 633 79 31
Telefax+41 31 633 79 29
www.gef.be.ch
info.kaza@gef.be.ch

Anne-Marie Maurer
Telefon+41 31 633 79 32
Telefax+41 31 633 79 29
anne-marie.maurer@gef.be.ch

Për

- prindër dhe fëmijë që ndjekin një çerdhe ditore fëmijësh
- prindër të nxënësve dhe nxënës të shkollave nacionale
- nxënëset dhe nxënësit si dhe ndjekësit e shkollave të mesme dhe profesionale
- bashkëpunëtorët e çerdheve, shkollave nacionale, shkollave të mesme dhe shkollave profesionale në Kantonin e Bernës

Bernë, prill, 2014

Albanische Übersetzung des Merkblattes über Masern für Kitas, Volksschulen, Mittelschulen und Berufsfachschulen

**Fletë informative për fruthin
dedikuar çerdheve, shkollave nacionale, shkollave të mesme dhe shkollave
profesionale**

Eliminimi i fruthit 2015:

- **Vaksinou kundër fruthit dhe mos humb asgjë;**
- **Kush është me fruth, me t'u shfaqur shenjat në lëkurë, për 4 ditë duhet të qëndrojë në shtëpi;**
- **Personat e pavaksinuar ose ata që nuk e kanë vuajtur më parë fruthin, pas një kontakti me një të prekur nga fruthi (të lindur me 1964 e më vonë), duhet të rrijnë në shtëpi deri në 21 ditë.**

Ç'është fruthi?

Fruthi është një sëmundje infektive tejet ngjitëse. Viruset e fruthit barten nga një person në tjetrin përmes pikëlave që shkaktohen gjatë kollitjes ose teshtimës. Simptomat e para që paraqiten një deri tri javë pas infeksionit janë: temperatura, rrufa, kollitja, pezmatimi i syve. Më vonë paraqiten shenjat tipike të fruthit në formën e njollave të kuqe. Këto përhapen duke u nisur nga fytyra deri në gjithë sipërfaqen e trupit, ndërsa temperatura arrin nivele të larta. Shpeshherë shfaqen dhe komplikime, sikurse janë pezmatimi i veshit të mesëm (70-90 raste në 1000), ndonjëherë pezmatimi i mushkërive (10-60 raste në 1000) ose pezmatimi i trurit/encefaliti (2-20 raste në 10.000). Mund të mbeten dhe gjymtime të caktuara, ndërsa në raste të rralla, fruthi mund të çojë deri në vdekje. **Sëmundja tek të rriturit shpesh ka një rrjedhë më të rëndë dhe shpesh paraqiten edhe komplikacione.**

Kur është fruthi ngjitës?

Fruthi është ngjitës qysh përpara se te personi i sëmurë të jenë shfaqur njollat e kuqe. Për këtë shkak fëmijët, të rinjtë dhe bashkëpunëtorët e paimunizuar të një institucioni, që kanë qenë në kontakt me një të prekur nga fruthi, ndonëse akoma nuk duken të sëmurë, sa më parë që të jetë e mundur, domethënë përpara se të bëhen edhe vetë infektues, duhet izoluar nga institucioni dhe të qëndrojnë në shtëpi.



Ç'ndodh në rast të rënies së fruthit në një çerdhe, në një shkollë nacionale, në një shkollë të mesme ose profesionale?

Për të evituar mundësinë e përhapjes së fruthit dhe për të mbrojtur ata që akoma nuk janë vaksinuar, ose që nuk u lejohej të vaksinohen (psh. foshnjat e moshës para 9-muajshe, personat me një sistem imunitar të dobësuar),

- gjatë katër ditëve pas fillimit të acarimit lëkuror, të sëmurët do të izoloohen prej institucioneve dhe do të qëndrojnë në shtëpi;
- **personat e pavaksinuar, të moshës nga viti 1964 e më të rinj¹**, që kanë qenë në kontakt me një të sëmurë, do të **izoloohen maksimalisht për 21 ditë**, qoftë edhe po të kenë pasur mundësinë e vaksinimit brenda 3 ditësh (72 orë) pas kontaktit të fundit me personin e sëmurë ose me gjithë faktin që fruthin tashmë e kanë pasur një herë. Të izoluarit duhet të **qëndrojnë në shtëpi**.

Bazat ligjore për këto masa do t'i gjeni në nenin 11 e 16 të Ligjit federal mbi luftën kundër sëmundjeve njerëzore ngjitëse (në Ligjin mbi epidemitë të 18 dhjetorit 1970 dhe në nenin 21 të Rregullores mbi zbatimin e legjislacionit federal për epidemi dhe tuberkuloz të 22 majit 1979.)

Si mund të mbrohem nga fruthi?

Vaksinimi është masa e vetme e mundshme preventive, përkatësisht, mbrojtja e vetme personale nga fruthi. Kundër fruthit po luftohet që prej 30 vitesh. Për një mbrojtje të plotë vaksinuese, fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit e moshës që nga viti 1964 e më pas, kanë nevojë për dy vaksinime kundër fruthit. Në rast se ju ose fëmija i juaj nuk jeni vaksinuar plotësisht (dmth. keni pasur vetëm një vaksinim) ju rekomandohet një rivaksinim deri në gjithsej **dy doza**.

Çfarë mund të bëni tani?

Kontrolloni statusin tuaj të vaksinimit dhe atë të fëmijës suaj (psh. përmes veglës ndihmëse Risiko-Check në faqen e internetit www.stopmasern.ch). Në librezën e vaksinimit substancat vaksinuese kundër fruthit janë shënuar nën emërtimet vijuese: Attenuvax, Moraten, Rimevax, Measles live vaccine, Eolarix, MoRuviraten, Triviraten, Biviraten, MMVax, Rimprix, MMR-II, MMRVaxPro, Pluserix, Priorix, Priorix Tetra. Po të jetë nevoja, ju, përkatësisht, fëmija i juaj, bëni një rivaksinim. Për të gjithë fëmijët dhe të rriturit e moshës nga viti 1964 e këtej vaksinimet e përsëritura me vaksinat kundër fruthit të licencuara në Zvicër, janë të liruara nga franshisa deri në fund të vitit 2015. Kushdo që do të vaksinohet kundër fruthit, shytave dhe rubeolës, i duhet të paguajë vetëm kontributin personal. Shpenzimet tjera i merr përsipër sigurimi shëndetësor.

Çfarë duhet të bëni nëse tek ju, ose te fëmija i juaj, janë zhvilluar simptomat e fruthit?

Në rast dyshimi për fruth duhet të konsultoheni me një mjek ose një mjekë. Personi i sëmurë nuk duhet të shkojë në çerdhe ose në shkollë, përkatësisht, fëmija i sëmurë duhet të qëndrojë larg çerdes. Para vizitës mjekësore, duhet që mjeken ose mjekun ta paralajmëroni përmes telefonit.

Nëse ju vetë jeni sëmurë nga fruthi, ose nëse fëmija i juaj është goditur nga fruthi, duhet ta informoni menjëherë drejtorinë e institucionit, me qëllim që kjo informatë të mund të përcillet në entin përkatës kantonial për shkak të inicimit të masave të domosdoshme.

Informacione të mëtejshme do të gjeni në faqet vijuese të internetit: www.stopmasern.ch.

ENTI MJEKËSOR KANTONAL

Dr. med. Jan von Overbeck
Kantonsarzt

¹ Personat e lindur me 1963 dhe më herët llogariten si të imunizuar.